Kronikë

I riu në Vlorë thyen arrestin shtëpiak, plagos me thikë fqinjin (EMRI+VIDEO)

Policia ka arrestuar një 28-vjeçar pasi gjatë një konflikti me një 34-vjeçar ka plagosur me thikë këtë të fundit dhe i ka dëmtuar mjetin.

[Sh.com] Redaksia
24 Maj, 09:10 | **Përditësimi: 24 Maj, 13:19**

Share

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

VLORË - Policia ka arrestuar një 28-vjeçar pasi gjatë një konflikti për motive ende të panjohura me një 34-vjeçar ka plagosur me thikë këtë të fundit dhe i ka dëmtuar mjetin.

Blutë njoftojnë se 28-vjeçar i identifikuar si Kejvi Bendaj pikësëpari ka thyer masën e sigurisë 'arrest në shtëpi' të caktuar ndaj tij nga gjykata.

Gjithashtu është vënë nën hetim edhe 34-vjeçari, pasi dyshohet se kanosi me armë gjahu 28-vjeçarin dhe i dëmtoi autimjetin.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Hapet për qarkullim tuneli i Llogarasë, fluks mjetesh! Deri më 15 shtator pa pagesë

Njoftimi i policisë:

Menjëherë pas marrjes së njoftimit për një konflikt të ndodhur në fshatin Panaja, shërbimet e Komisariatit të Policisë Vlorë ndërhynë në kohë dhe parandaluan përshkallëzimin e tij, që mund të kishte sjellë pasoja të rënda.

Si rezultat i veprimeve të shpejta, u arrestua në flagrancë shtetasi K. B., 28 vjeç, banues në Panaja, i cili kishte thyer masën e sigurisë "Arrest në shtëpi", të caktuar nga Gjykata, për veprat penale "Plagosja e rëndë me dashje" dhe "Shkatërrimi i pronës".

Gjithashtu, u referuan materialet në Prokurori ku nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasin B. B (H)., 34 vjeç.

Shtetasi K. B. dyshohet se për motive të dobëta, ka goditur me thikë shtetasin B. B. dhe i ka dëmtuar automjetin atij. Më pas, shtetasi B. B ka shkuar te banesa e shtetasit K. B., i ka dëmtuar automjetin dhe e ka kanosur atë, me një armë gjahu të cilën e posedonte pa leje.

Shtetasi B. B. mori mjekim dhe është jashtë rrezikut për jetën.

Materialet procedurale iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për veprime të mëtejshme.

K.M/SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Kejvin Bendaj | Vlore

Komento

Komente

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Berisha kërkon anulim të zgjedhjeve, si ju duket?

24 Maj, 14:02

Alibi për humbjen | Kërkesë me bazë | I/e dyzuar

Lajme të tjera

Nga 24 maji deri në 15 shtator, tuneli i Llogarasë pa pagesë
23 Maj, 16:50

Zgjedhjet/ KQZ certifikon rezultatet edhe për Vlorën, Fierin, Lezhën dhe Gjirokastrën
23 Maj, 16:39

Njëri shiste kokainë në Sarandë dhe tjetri hashash në Vlorë, policia prangos 2 tregtarët e drogës! (EMRAT+VIDEO)
22 Maj, 16:24

Sekuestrohet autobusi i agjencisë të kryetarit të PD-së në Sarandë, trafikonte emigrantë drejt Greqisë
22 Maj, 15:53

Pas operacionit 'Ura', shtohen kontrollet e imtësishme në portin e Vlorës
22 Maj, 10:10

Moti i keq/ Pezullohet lundrimi i mjeteve të vogla në Vlorë! Tragetet do të operojnë normalisht sipas destinacioneve
21 Maj, 12:37

Ardit Bido për Report Tv: 83 mandatet e PS s'janë rrezik, u dhanë për integrimin në BE! Problemet në Greqi për shkak të postës
20 Maj, 18:31

Rikthimi në elitë pas 5 vitesh, Flamurtari nis rikonstruksionin e stadiumit! Idrizi: Investim i yni, do rrisim nivelin e futbollit shqiptar
19 Maj, 15:06

Djegia e një beach bar-i në Borsh, policia nis hetimet
19 Maj, 13:13

Sarandë/ Dyshohet se i shiti drogë 15-vjeçares, nis hetimi për të riun! Adoleshentja përfundon në spital
19 Maj, 11:41

'E bëre tërmet prapë Damian', Çollaku pas humbjes së thellë: Krenar që votova kundër Kodit Zgjedhor, një pjesë e opozitës votoi në mënyrë naive
18 Maj, 21:01



Greqi/ Armë, antiplumb e targa false në banesë, në pranga 32-vjeçari nga Saranda (EMRI+VIDEO)

Limos Didani

18 Maj, 11:35

© 2011 - 2025 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i pasaut orizuar i kesaj faqeje